




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivuty	31-01-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	416/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1176/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmetianëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1176/2021 të datës 16.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

me adres banimi Komuna e Prishtinës, kundër Vendimi KA.nr.58/2021 me numër të protokollit 01/19/1 të datës 09.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1176/2021 e datës 16.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.58/2021 me numër të protokollit 01/1971 të datës 09.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër GJ.A-Su. A 211/19 të datës 01.04.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtarë i Teknologjisë Informative IT", i cili me datë 12.11.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 01/1825 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për shkak të: "mos zbatimit të Vendimit KGJK.nr.152/2021 të datës 28.05.2021 pika dy (2) për dhënien e shtesave në pagë për stafin e T1-së në KGJK dhe gjykata në mënyrë retroaktive nga data e fillimit të punës së tyre".

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 09.12.2021 me numër të protokollit 01/1971 merr vendimin KA.nr.58/2021 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimi KA.nr.58/2021 me numër të protokollit 01/1971 të datës 09.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të

Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 16.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 6172/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.12.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 26.01.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/8.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 16.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.04.2019; Vendimi i datës 28.05.2021 i Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi i datës 09.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesa e datës 12.11.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; E-mail-at e datave 08.12.2021, 18.11.2021, 09.12.2021, 18.08.2021, 10.08.2021; Lista e pagave si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi me datë 02.04.2019 ka nënshkruar Akt emërimit për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informativ (IT)", në njësinë Udhëheqës të Zyrës për Shërbime të Përbashkëta në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa me datë 28.05.2021 me numër KGJK.nr.152/2021 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka nënshkruar vendimin për dhënien e shtesave në pagë për stafin e TI-së të punësuar në KGJK dhe gjykata, dhe në dispozitivin e dytë të këtij vendimi është cekur se: "Dhënia e shtesave në pagë për stafin e TI-në KGJK-së dhe gjykatave do të fillojë së zbatuari në mënyrë retroaktive nga data e fillimit të punës së tyre". Ankuesi pa kënaqur me mosrealizimin e plotë të pagesës së shtesës në pagë, me datë 12.11.2021 parashtron ankesë me numër të protokollit 01/1825 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ" si dhe neni 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe të nenit 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, pasi që me datë 28.05.2021 me numër KGJK.nr.152/2021 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka nënshkruar Vendimin me të cilën aprovohet kërkesa për dhënien e shtesave në pagë për stafin e TI-së të punësuar në KGJK dhe gjykata, e po ashtu edhe dhënia e shtesave në pagë për stafin e TI-së në KGJK-së dhe gjykata do të fillojë së zbatuari në mënyrë retroaktive nga data e fillimit të punës së tyre, ndërsa ankuesi me datë 12.11.2021 ka parashtruar ankesë jashtë afatit të përcaktuar ligjor në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për

mosrealizimin e plotë të pagesës së shtesës në pagë, me pretendim ankimor për realizimin e shtesës në mënyrë retroaktive nga data 01.04.2019 deri më 31.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se, ankuesit ka filluar ti rrjedhë afati ligjor për ankimim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data 01.07.2021, datë kur ka kuptuar se në xhirollogarinë e tij nuk i është bërë pagesa e plotë e shtesës në pagë të TI-së në mënyrë retroaktive sipas Vendimit me numër KGJK.nr.152/2021 të datës 28.05.2021 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe se ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor e ka parashtruar jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur ankuesit i janë shkëlur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës në kundërshtim me dispozitat Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.58/2021 me numër të protokollit 01/1971 të datës 09.12.2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka arritur të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, respektivisht afatshmërin e parashtrimit të ankesës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Arkivit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1176/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

